

Ç'është sëmundja e Blutongut (gjuha blu)?

Sëmundja e Blutongut (**gjuha blu**) është një sëmundje infektive jo ngjitëse (nuk përhapet nga kafsha tek kafsha nëpërmjet kontaktit), virale, specifike për rypërtypësit(dhën, gjedhë dhe dhi) dhe që karakterizohet me zhvillim të rëndë sidomos tek dhëntë por edhe tek gjedhi e rrallë tek dhitë. Sëmundja nuk prek qentë dhe kuajt. Shakaktari i sëmundjes është një virus i cili transmetohet gjatë pickimit të mushkonjave(vektorit) të cilat janë infektuar më parë me virusin në fjalë. Sëmundja ka karakter mjaft përhapës, shkakton dëme ekonomike të mëdha, si në drejtim të vdekjes së kafshëve të prekura, humbjes së prodhimit të qumështit(deri 50%) të prodhimit, leshit dhe qëngjave. Këto dëme arrijnë në rreth 3 miliardë dollarë në vit. Për këtë arsye ajo (sëmundja) konsiderohet si një problematikë e rëndësishme ndërkombëtare. Blutongu(gjuha blu) është sëmundje e listës së OIE-së(Organizata Botërore e Epizootisë), e detyrueshme për deklaram. Sëmundja, historikisht e ka patur djepin e vet në Afrikë. Në Europë, deri në vitin 1998, kishte vetëm disa raste të rralla të saj, kurse tashmë disa serotype të tij vrehen rregullisht në kontinentin Europian. Kjo ka ardhur si pasojë e adaptimit të transmetuesit të virusit të sëmundjes në fjalë (vektorit) në kushtet klimatike të Europës, si pasojë e ndryshimeve të dukshme klimatike botërore që kanë ndikim pozitiv të vektori(mushkonja). Sëmundja e Blutongut, karakterizohet nga përhapje e shpejtë, menjëherë mbas shfaqjes së rasteve të para në një vend.

Si është aktualisht e përhapur sëmundja e Blutongut

Sëmundja e Blutongut (gjuha blu), për shumë vite me rradhë ka qënë prezentë në pjesën jugore të Afrikës. Duke filluar nga viti 1940, ajo u vrejt në rajonin e Mesdheut dhe në kontinentin Aziatik. Aktualisht sëmundja e Blutongut (gjuha blu) është mjaft e përhapur në botë dhe thuajse vrehet në të gjithë botën. Në Europë, sëmundja e blutongut (gjuha blu) po përhapet gjithnjë e më tepër në veri të saj, gjë e pazakontë për sëmundje të këtij lloji. Kjo ka ardhur si pasojë edhe e ngrohjes globale, e cila krijon kushte të përshtatshme (ngritje temperature) edhe në këto zona. Në këto kushte, (nga ngrohja globale), kur mesatarja vjetore e muajve janar dhe shkurt, është 12 gradë e më tepër , krijohen kushte të favorshme për të ruajtur pasardhësit e infektuar të mushkonjave, të cilët me fillimin e pranverës shtohen dhe përhapen në të gjithë zonat përreth. Mushkonjat lëvizin me shpejtësi nga njera zonë në tjetrën(1.5-2 km në ditë), duke pickuar kafshët dhe duke përhapur sëmundjen. Në sipërfaqet ujore ajo lëviz deri në 200 km. Prezenca e erërave të lehta, me më pak se 8 km në orë, ndihmojnë akoma më tepër në përhapjen e

mushkonjave të infektuara. Në shtimin e mushkonjave, rol të rëndësishëm lozin dhe shirat e shumtë si dhe rezatimi diellor. Këto faktorë ndikojnë dukshëm në shtimin e sasisë së tyre, të cilat në orë të ndryshme të ditës sidomos nga ora 10 para dite deri në 4 mbas dite, kohë kjo që duhet të kihet parasysh në rastin e nxjerrjes në kullotë të bakëtime, kanë dhe aktivitetin e tyre maksimal. Në vendet ku nuk ka mushkonja të llojit të *Culicoideve*, nuk vrehet as sëmundja. Në vendin tonë sëmundja e Blutongut (gjuha blu) është evidentuar për herë të parë në vitin 1998 në rrethin e Pogradecit. Që nga kjo periudhë ajo u përhap, pa ndonjë klinikë të rëndë, thuasje në të gjithë Shqipërinë. Më pas, ajo është shfaqur herë mbas here, në zona të ndryshme dhe me intensitet klinik të ndryshëm. Sot në vendin tonë, sëmundja është shumë e përhapur dhe vazhdon të zgjerojë mjaft spektrin e vet gjeografik. Ajo është e përhapur gjithashtu edhe në shtetet fqinjë. Dëmi ekonomik është i lidhur me llojin e virusit që qarkullon në vend i cili ndryshon vazhdimisht.

Sëmundshmëria dhe vdekshmëria

Kur sëmundja shfaqet për herë të parë, sëmundshmëria luhet nga 50-75%, por mund të arrijë deri 100% të tufës së prekur, ndërsa vdekshmëria lëviz nga 2 - 30% dhe në disa shpërthime mund të jetë edhe më e lartë deri në 50% të krerëve të prekur.

Si infektohen kafshët?

Shkaktari i sëmundjes si u përmënd, përhapet nëpërmjet mushkonjave *Culicoides*. Këto insekte sidomos specia femër, gjatë thithjes së gjakut tek kafsha e pa infektuar, ose dhe e infektuar, fut dhe virusin në to, ose dhe merr nga kafsha, së bashku me gjakun, edhe virusin, kur kafsha është e infektuar. Virusi, përgjegjës i sëmundjes, shumëzohet edhe tek organizmi i mushkonjës. Insekte të tjerë gjakthithës si riqnat dhe morrat e dhënve, mundet të transferojnë virusin tek kafshët. Virusi, nuk përhapet nëpërmjet kontaktit direkt me kafshën e prekur por mund të përhapet sidomos nga objektet e kontaminuara, të tilla si paisjet kirurgjikale si dhe aget (përdorimi i një agete për marjen e gjakut në shumë kafshë, nuk është e lejueshme). Virusi i sëmundjes mund të kalojë nga nëna barse tek pasardhësit. Virusi shkakton edhe dështime në dhën e gjedhë.

Cilat janë shenjat klinike të sëmundjes së gjuhës blu?

Periodha e inkubacionit të sëmundjes zakonisht luhet nga 5 deri në 10 ditë. Klinikë e sëmundjes së Blutongut (gjuhës blu) vrehet më tepër në dhëntë, por në disa raste edhe tek gjedhi.

Dhëntë janë kafshët më të ndjeshmë kundrejt sëmundjes. Sëmundja, tek këto specie, zhvillohet në disa forma si: në **formën e shpejtë** (akute), në **formën jo të shpejtë** (nënakute) si dhe në **formën e dështuar** (abortive). Njohja e mirë e shenjave të sëmundjes në fjalë si nga ana e fermerëve por edhe e mjekëve veterinarë, ndikon dukshëm në marjen e herëshme të masave të mundshme për të minimizuar në maksimum dëmtimet.



Foto 1: Delvine, Shtator 2014 Foto nga Dr Gazment Rugji



Foto 2: Tetove, Maqedoni, Shtator 2014 Foto nga Dr Lazim Zurapi

Sëmundja shfaqet papritur me ngritje temperature, deri në 42° e cila zgjat nga 6 deri në 8 ditë. Kafshë është depresive dhe ka anoreksi. Më pas, shfaqen shënjat e para klinike, të kryesisht në mukozën e gojës dhe të hundës dhe mandej në gjymtyrët si dhe në muskuj. Në fillim mukoza është e përskuqur dhe që shoqërohet me jargëzime me shkumë. **Tipike në këtë rast është fakti që kafsha kalon gjuhën mbi buzë dhe bën një zhurmë fishkëlluese.** Nga hundët

vrehen rrjedhje seroze, ndërsa sytë lotojnë. 1 ose dy ditë më von shfaqen edemat dhe hemorragjitë në gjuhë, buzë dhe faqe(deri tek veshët). Në vazhdim, rrjedhjet bëhen hemorragjike, gjuha ënjtet, merr ngjyrë blu deri në cianotike, nga ku sëmundja ka marrë dhe emrin. Më vonë, lezonet në gojë, kalojnë në formën ulçerative, me zona të xhveshura hemorragjike, të cilat në përgjithësi kontaminohen me mikrobe banalë që e komplikojnë fenomenin si dhe vështirësojnë ngrënien e ushqimit.



Foto 3: Gjakove, Kosove, Stator 2014, Nga Dr Nue Ibra

Buzët dhe turinjtë, janë të mbuluara me kruste që gjakosen lehtësisht. Goja , për shkak të dhëmbjeve, mbetet e hapur dhe gjuha del jashtë nga kaviteti, e cila me kalimin e kohës edhe gangrenizohet. Rreth ditës së gjashtë, ndërsa temperatura fillon të bjerë, shfaqen lokalizimet në gjymtyrë, që manifestohen me çalime, si pasojë e të thundrës. Në këtë fazë, thundrat janë të skuqura, të dhimbshme, që në rast komplikacionesh si pasojë e kapjes me vonesë dhe mos

marrjes së masave, mund të përfundojë me rënien e thundrës. Në momentet e fundit mund të vrehen përdredhje koke(tortiokolis) si dhe kthimi i kokës nga ana e shpatullës. Kafsha vdes për 10-12 ditë, ose shkon drejt përmirësimit. Shërmi total ndodh pas një periudhe të gjatë kovaleshence. Kapja e shpejtë e sëmundjes nga fermeri dhe specialisti veterinar, ndihmon në shpejtimin e procesit të përmirësimit të kafshës dhe kufizim të humbjeve. Kafshët barsa mund të dështojnë dhe qingjat janë të dobët ose lindin me keqformime. Shënjat mund të hasen edhe në qingja, nëse ato nuk marrin sasinë e nevojshme të kulloshtres. Kur qëngjat marrin kulloshtren ata janë të mbrojtur nga 5-6 muaj.



Foto 4: Fierze, Puke, Dr Abdyl Arifaj Shtator 2014

Në dhi - sëmundja përgjithësisht zhvillohet pa shënja klinike, por nëse ajo zhvillohet, është e ngjajshme me klinikën në dhën.

Në gjedhë, shënjat klinike manifestohen rrallë, por nëse ato shfaqen përfshijnë: temperaturë 40 -42 °C, ecje si e shtangur dhe çalim në të katër gjymtyrët, jargëzim i shtuar, edemë e buzëve dhe e nëngushës, rrjedhje nga hundët, ulçeracion të mukozës orale, erë e keqe nga goja, koronit, oftalmit dhe omfaloflebit. Lopët e infektuara gjatë barsmërisë mund të dështojnë ose të lindin viça me keqformime. Diagnoza e sëmundjes bazohet në të dhënat epidemiologjike, klinike dhe pjesërisht ato anatomo patollogjike, të cilat janë mjaft orientuese për vendosjen e diagnozës së Blutongut (gjuha blu). Elementi më i rëndësishëm në pikëpamjen e klinikës është ngjyra e blu e gjuhës, por meqënëse jo në të gjitha rastet vrehet kjo formë klinike, atëherë diagnoza konfirmohet në laborator, ku dërgohen kampione gjaku, të marrë nga kafshët e infektuara (10-15 ditë mbas shfaqjes së shënjave klinike) si dhe nga kafsha e vdekur dërgohen nyje limfatike të rejlioneve të ndryshme. Diagnoza e Blutongut (gjuhës blu) vendoset mbi bazë grupi apo dhe tufe.



Foto 5: Durres, Shtator 2014



Foto 6: Gjiri i lopes, Durres, Shtator 2014

Blutongu(gjuha blu) duhet të diferencohet nga sëmundje të tilla si lija e dhënve dhe dhive, ektima ngjitëse, stomatiti ulçeroz ngjitës i qëngjave, afta epizootike, murtaja e të imtave dhe e gjedhit, encefalitet arborvirale dhe fotosensibilizimi.

Për të bërë këtë diagnozë diferenciale, me shfaqjen e shenjave të para të sëmundjes, menjëherë njoftohet mjeku veterinar më i afërt shtetëror apo privat i cili është i aftë të bëjë dhe diferencimet përkatëse.

Përgatiti për revistën “Veterineret”

Prof. Dr. Kristaq BËRXHOLI
Fakulteti i Mjekësisë Veterinare
Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar
Tiranë